

VENDIM
Nr.41, datë 31.1.2007

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.704, DATË 11.10.2006 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KRITERET E VLERËSIMIT TË PRONËS SHTETËRORE, QË
PRIVATIZOHET, SI DHE PËR PROCEDURËN E SHITJES”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në kapitullin III të vendimit nr.704, datë 11.10.2006 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

1. Në shkronjën “b” të pikës 2, fjalët “...njoftim i dytë në dy gazeta me tirazh të lartë...”, zëvendësohen me “...njoftim i dytë në dy buletine të njëpasnjëshme të njoftimeve publike, sipas datës së përcaktuar nga Ministria e Financave (Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike) në njoftimin për botim...”.

2. Shkronja “a” e pikës 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a) Periudha e botimit zgjat 21 ditë nga data e botimit të parë dhe bëhet në çdo botim të Buletinit të Njoftimeve Publike, brenda këtij afati. Data e parë e botimit është data e përcaktuar në njoftimin që Ministria e Financave (Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike) dërgon për botim.”.

3. Në paragrafin e dytë të pikës 10, fjalët “...në një gazetë kombëtare...”, zëvendësohen me “...në një botim të Buletinit të Njoftimeve Publike, sipas datës së përcaktuar nga Ministria e Financave (Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike) në njoftimin për botim...”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha